



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 790/2022
Datë: 17 qershor 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 9 të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 17 qershor 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Komisioni për Rishqyrtim, në këtë përbërje:
 1. Shqipdon Fazliu, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit – Kryesues;
 2. Ardian Hajdaraj, Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës – anëtar;
 3. Arian Gashi, Prokuror në Prokurorinë e Apelit – anëtar.
- II. Anëtarë rezervë të Komisionit për Rishqyrtim do të jenë:
 1. Armend Zenelaj, Anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
 2. Idain Smailji, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- III. Obligohen anëtarët nga pikat I dhe II të këtij Vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të Rregullores Nr. 02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve në pikën I dhe II të Vendimit;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së.